



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Primiljeno/Prodato Received/Delivered	13.01.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtori e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMSHICK	328/2023		1/3



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

**A.nr.1100/2023**

**Këshilli i Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga:** Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtare, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1100/2022 të datës 05.12.2022, të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit Komuna e Mitrovicës së Jugut, në çështjen juridike "*kompenzim material*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 13.01.2023, njëzëri mori këtë:

**V E N D I M**

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.1100/2022 e datës 05.12.2022 e parashtruar nga ankuesi

**A r s y e t i m**

Ankuesi i punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut, me datë 05.12.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor që t'i njihet e drejta e kompensimit në mënyrë retroaktive të diferencës së koeficientit të pagës nga 7.5 në 8.5 për pozitën "Shef i Sektorit për Çështje Sociale", duke filluar nga data 20.11.2014 kur është nxjerrë shkresa udhëzuese e Departamentit për Administrimin e Shërbimit CIVIL DASHC/MAP-04/1571 deri në kohën kur është aprovuar nga Këshilli ngritja e koeficientit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 7639/2022 të datës 05.12.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen me numër të referencës 01-120/08-0104638/22 të datës 23.11.2022 të Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës së Jugut; Vendimin në Këshillit A.nr.837/2022 të datës 08.11.2022;



Zarfin Postar të datës 01.12.2022; E-mailin e datës 17.11.2022 dërguar nga [redacted] për Këshillin; Vendimin e datës 17.11.2022 të Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Jugut me numër:01-120/04-0103277; Akt emërimit e ankuesit të datës 26.11.2013.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi së ankesa e ankuesit [redacted] është parashtruar jashtë afatit ligjor, *sepse*:

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë së ankuesi më datë 22.11.2022 ka parashtruar kërkesë të Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Mitrovicës së Jugut për kompensim të demit material në mënyrë retroaktive duke filluar nga data 20.11.2014 kur është nxjerrë shkresa udhëzuese e Departamentit për Administrimin e Shërbimit CIVIL DASHC/MAP-04/1571 për përcaktimin e koeficientëve e deri me datë 17.11.2022 kur i është bërë ndryshimi koeficientit përmes Vendimit me numër:01-120/04-0103277 të kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Menaxheri i Burimeve Njerëzore i Komunës së Mitrovicës së Jugut përmes përgjigjes së datës 23.11.2022, ka njoftuar ankuesin se pretendimin për kompensim retroaktiv të koeficientit nga 7.5 në 8.5 nga vitit 2014 e tutje konsiderohet i pabazuar, ndërsa realizimi i koeficientit në 8.5 vlen vetëm pas Vendimit A.nr.837/2022 të datës 08.11.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i cili është zbatuar sipas vendimit të Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Jugut me datë 17.11.2022.

Kolegji lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit ka gjetur së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duke vendosur lidhur me ankesën e ankuesit të datës 30.09.2022, me Vendimin A.nr.837/2022 të datës 08.11.2022 ka njohur të drejtën e ankuesit për harmonizimin e koeficientit të pagës nga 7.5 në 8.5, ndërsa përkitazi me pretendimin ankimor të ankuesit për kompensim të demit në mënyrë retroaktive nga data 20.11.2014 për pozitën "Shef i Sektorit për Çështje Sociale" deri në Ndryshimin dhe Plotësimin e Akt-it të Emërimit sipas Vendimit të datës 17.11.2022 të Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Jugut, Kolegji i këshillit bazuar në provat e administruara ka konstatuar së në kohën e nënshkrimit të Aktit të Emërimit të datë 26.11.2013 me të cilin ankuesi ishte emëruar "Shef i Shef i Sektorit për Çështje Sociale" ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Ligji Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, andaj mbi këtë bazë Kolegji vlerëson se ankesa e parashtruar në Këshill lidhur me pretendimin për kompensim e diferencës së koeficientit të pagës në mënyrë retroaktive nga data 20.11.2014 është ushtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 8 paragrafin 2 të Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, ku është përcaktuar se: "...Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës" si dhe nenin 130 paragrafi 1 të Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative me të cilin përcaktohej se: "Ankimi administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose për refuzimin për të nxjerrë aktin; b) akti është shpallur në bazë të dispozitave të këtij Ligji ose ligjeve të tjera në fuqi.", kështu që meqenëse ankuesi nga data e nënshkrimit të Akt Emërimit të datës 26.11.2013 e deri me datë 30.09.2022 nuk ka ndërmarr ndonjë veprim juridik në kuptim të kompensimit në mënyrë retroaktive të koeficientit të pagës rrjedh se ankesa e ankuesit



A.nr.837/2022 e datës 05.12.2022 është parashtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar edhe me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative me të cilin është përcaktuar se: "Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ".

Theksuar si me sipër, dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 129 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr. 1100/2022, datë 13/01/2023

**Flakron Gashi**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Arben MEHMETI**

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Jugut;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Mitrovicës së Jugut dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;